

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Jakup Krasniqi mesazh nga Haga: Mirënjohje për mbështetjen dhe besimin gjatë gjithë këtij procesi - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/jakup-krasniqi-mesazh-nga-haga-mirenjohje-per-mbeshtetjen-dhe-besimi-n-gjate-gjithe-ketij-procesi/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 09:06:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 09:01:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aa70f41bc746abe83cfa2ef54dde01536b7d08dde7d2a4e9c88ca9c774a6a49b
TEKSTI	a7f287253059115d264a523aa55925ab95729c8f9d708da4a7be074b43bb81aa
PAMJA	b0d7256a5a942d492b2b3f625be899db767be0c672488e7492a9c20865c58b4d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	12c9846d89bd67f7d83599c0ba3f04a0ca3b9481d0d17f7a9ca4fed612d981d3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	219f872b2d436154cbce21b1357d2a6f04cc2d43ba2a7914d91c1ebdf0665477
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/12c9846d89bd67f7d83599c0ba3f04a0ca3b9481d0d17f7a9ca4fed612d981d3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK SHBA Donald Trump Bajram Begaj Poloni

KOSOVË | RAJONI

Jakup Krasniqi mesazh nga Haga: Mirënjohje për mbështetjen dhe besimin gjatë gjithë këtij procesi

18 Shtator 2026 | 11:01

Mbrojtja e ish-kreut të UÇK-së, Jakup Krasniqi, ka shprehur zhgënjim të thellë ndaj dënimit me 25 vite burg nga Gjykata Speciale, duke paralajmëruar apelimin e menjëhershëm të këtij vendimi. Në një deklaratë zyrtare, avokatja kryesore Venkateswari Alagendra theksoi se provat e rëndësishme të paraqitura gjatë procesit nuk janë marrë parasysh ose nuk u është dhënë pesha e duhur ligjore.

Mbrojtja shtoi vendimi i vetëm i drejtë do të ishte pafajësia e plotë për të gjitha akuzat. Sipas mbrojtjes, përgjatë dy viteve gjykim asnjë dëshmitar nuk ka dëshmuar për keqtrajttime nga Krasniqi apo në prani të tij, ndërsa dëshmitarët ndërkombëtarë dhe ata të prokurorisë e kanë përkrahur atë si një lider të moderuar dhe bashkëpunues.

Ajo gjithashtu ka përcjellë mirënjohjen e Krasniqit për njerëzit e Kosovës, për mbështetjen e vazhdueshme dhe besimin që kanë pasur tek ai gjatë gjithë këtij procesi.

Reagimi i plotë:

Natyrisht, jemi thellësisht të zhgënjyer nga aktgjykimi i gjyqtarëve të trupit gjykues. Do të marrim kohë për të shqyrtuar dhe analizuar me kujdes arsyetimin e plotë të gjyqtarëve, por tashmë është e qartë se prova të rëndësishme të paraqitura gjatë gjyqimit ose nuk janë marrë siç duhet në konsideratë, ose nuk u është dhënë pesha e duhur.

Në këto rrethana, është e qartë se do ta apelojmë këtë aktgjykim. Qëndrimi ynë është se, bazuar në provat e paraqitura, rezultati i vetëm i përshtatshëm do të ishte shpallja i pafajshëm e Jakup Krasniqit për të gjitha akuzat.

Është gjithashtu për të ardhur keq që Jakup Krasniqi, i cili është pothuajse 76 vjeç, ka kaluar në paraburgim gati 6 vite të jetës së tij. Gjatë kësaj kohe, ai jo vetëm që ka qenë larg familjes dhe Kosovës së tij të dashur, por është dashur të jetojë me akuzat që bien ndesh me punën e tij jetësore për të drejtat e njeriut, barazinë dhe lirinë.

Dëshmitarë të shumtë kanë dëshmuar se ai është një demokrat i vërtetë, një lider i moderuar dhe një person që ka qenë gjithmonë bashkëpunues në marrëdhëniet e tij me komunitetin ndërkombëtar.

Është e rëndësishme të kuptohet se, qatë më shumë se dy viteve të gjyqimit, asnjë

LAJMI I FUNDIT

11:00 Rekomandimet e KiE për paraburgimin, Gogu: Po rishikojmë Kodin e Procedurës Penale

10:50 Instituti Amerikan i Paqes kërkon bllokimin e gdhendjes së emrit të Trump në fasadën e selisë së tij

10:42 Venezuela zhblokon faqet e lajmeve të censuruara gjatë administratës së Maduro-s

10:39 Policia e Kosovës u bën thirrje protestuesve që të mos mbajnë maska

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

10:36 PDK pritet të dorëzojë sot në Kuvend nismën për ndryshimin e Ligjit për Specialen

10:33 Presidenti Begaj dekreton ligjin për pagat e magistratëve

TESTIM

dëshmitar nuk dëshmoi se ishte keqtrajtuar nga Jakup Krasniqi apo se ishte keqtrajtuar në praninë e tij. Përkundrazi, shumë dëshmitarë ndërkombëtarë dhe dëshmitarë të Prokurorisë nga Kosova folën me vlerësime shumë pozitive për natyrën e ekuilibruar të z. Krasniqi dhe mënyrën se si ai sillej.

Është një realitet i trishtueshëm që Jakup Krasniqi ka humbur 16 vite të jetës së tij për shkak të akuzave që, sipas nesh, nuk duhej të ishin ngritur kurrë: 10 vite të jetës së tij u morën kur ai u burgos padrejtësisht nga regjimi serb i Millosheviqit, ndërsa gati 6 vite të tjera i ka kaluar i ndaluar në lidhje me akuzat aktuale.

Z. Krasniqi është krenar që ka luftuar për Kosovën e re që lindi në vitin 1999 dhe shpreson që brezi i ri i kosovarëve të mos i marrë kurrë liritë si diçka të garantuar.

Lufta është e shëmtuar dhe mizore, edhe kur është e domosdoshme. Shumë njerëz – në të gjitha anët – vuajtën jashtëzakonisht shumë gjatë konfliktit të shkaktuar nga regjimi i terrorit të Millosheviqit dhe mendimet e z. Krasniqi vazhdojnë të jenë me të gjithë ata që pësuan humbje.

Ndërsa ne, si ekip i tij ligjor, do të shqyrtojmë mundësitë e apelimit dhe mjetet e tjera juridike, z. Krasniqi e kupton se kjo çështje është më e madhe se ai vetë

Historia nuk mund të rishkruhet. Mbrojtësit e jetës dhe lirisë, për të cilat UÇK-ja aspironte dhe punoi, nuk mund të paraqiten tani si fajtorët e historisë. Çdo përpjekje për ta bërë këtë duhet të dënohet.

Edhe përballë këtij aktgjykimi thellësisht zhgënjyës, z. Krasniqi më ka kërkuar t'u përcjellë mirënjohjen e tij njerëzve të Kosovës, për mbështetjen e vazhdueshme dhe besimin që kanë pasur tek ai gjatë gjithë këtij procesi.

Shiko në:

| LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË

Policia e Kosovës u bën thirrje protestuesve që të mos mbajnë maska

Policia e Kosovës ka lutur qytetarët që po protestojnë kundër vendimit dënues të Gjykatës Speciale ndaj ish-krerëve të UÇK-së që të mos mbajnë maska gjatë...

10:39 | 18/09/2026

KOSOVË

PDK pritet të dorëzojë sot në Kuvend nismën për ndryshimin e Ligjit për Specialet

Partia Demokratike e Kosovës pritet të dorëzojë sot në Kuvend propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit...

10:36 | 18/09/2026

KOSOVË

OVL-UÇK sot protestë kundër vendimit të Speciales ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK) ka thirrur për sot protestë gjithëpopullore në Prishtinë, pas aktgjykimit ndaj katër ish-krerëve të...

10:18 | 18/09/2026

TEMA

- Vendi
- Rajoni
- Bota
- Video

SHËRBIME

- Live
- Lajmi fundit
- Na ndiqni
- Euronews Radio
- Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

- Rreth Euronews
- Kushtet e përdorimit
- Politika e cookie
- Kontakttoni
- Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.